



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1160/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Adifete Emini kandidate për asamblenë komunale në Ferizaj nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ)-Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për shkak të mungesës së votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2012, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e Adifete Emini kandidate për asamblenë komunale në Ferizaj nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK),

URDHËROHET KQZ që të rinumëroj fletëvotimet në Vendvotimin 2511D/01R dhe ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të 3 Nëntorit 2013.

A R S Y E T I M

PZAP-i me datën 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Adifete Emini kandidate për asamblenë komunale në Ferizaj nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën pretendon se në VV 2511D/01R sipas informatave i ka 25 vota, ndërsa sipas rezultatit përfundimtar të QNR-KQZ ka 0 vota.

Parashtruesja e ankesës ka bashkangjitur një deklaratë të kryesuesve të VV 2511D/01R, Ideal Bekteshi, Shkurte Metushi dhe Kujtim Ilazi në të cilën thuhet se votat e kandidates në fjalë janë bartur nga numri 36 në numrin 35.

PZAP-i pas shqyrtimit dhe analizimit gjeti se:

- **ankesa është e bazuar**

PZAP-i nga shkresat e lëndës të ofruara nga pala ankuese si dhe nga deklaratat e ofruara si dëshmi është vërejtur se ka pasur parregullsi gjatë plotësimit të formularit sepse në të nuk figurojnë votat e kandidates në fjalë, andaj urdhërojmë që të bëhet

rinumërimi në këtë VV. Andaj PZAP-i në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në këto vendvotimeve. Andaj PZAP nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura si dhe në mbështetje të 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 1160/2013 më datën 06.12.2013.

Kryesuesi Panelit
Ferit Osmani



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund te paraqitni ankese ne Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njezetekater (24) oreve nga moment i marrjes se vendimit nga PZAP-i